



BASHKIA E TIRANËS DHE MBËSHTETJA PËR BIZNESET E GJELBRA: NË HAPAT E SË ARDHMES SË QËNDRUESHME

Në përpjekjet për të bërë Tiranën një model të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ekologjik, Bashkia e Tiranës ka shpallur një sërë iniciativash për mbështetje të bizneseve të reja dhe ekzistuese që përqafojnë praktika miqësore me mjedisin. Projekti ka si qëllim kryesor të stimulojë dhe të nxisë sipërmarrësit të krijojnë dhe të zhvillojnë biznese "të gjelbra" që respektojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësojnë qëndrueshmërinë ekologjike të kryeqytetit.

Për realizimin e këtij qëllimi, që lidhet ngushtësisht edhe me kapitujt e integritimit në Bashkimin Evropian, Bashkia e Tiranës ka celur programin që ofron mbështetje financiare për biznese të reja dhe ekzistuese që dëshirojnë të implementojnë modele eko-miqësore.

Nëpërmjet programit mbështetës për bizneset e gjelbra, Bashkia Tiranë syon të krijojë një ambient të favorshëm për zhvillimin e ideve miqësore me mjedisin dhe që ndihmojnë në reduktimin e ndikimeve negative në natyrë. Projekti i Bashkisë së Tiranës është në përputhje të ngushtë me qëllimet dhe kërkesat e Kapitullit 27 për integrim në Bashkimin Evropian, i cili fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Kapitulli 27 kërkon nga shtetet anëtare të adoptojnë praktika që mbrojnë burimet natyrore dhe reduktojnë ndikimet mjedisore negative.

Projekti i Tiranës për bizneset e gjelbra është plotësisht në përputhje me prioritetet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane (European Green Deal), një nismë e BE-së që synon të bëjë Evropën kontinentin e parë me emetime neto zero deri në vitin 2050.

Jo vetëm kaq, por Bashkia Tiranë në dokumentin themelor të saj për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit deri në vitin 2027 ka ndërmend zhvillimin edhe të një sërë politikave të tjera miqësore me mjedisin.

Deri në fund të vitit 2025 është vendosur objektivi për mbështetjen e 100 bizneseve vendore drejt artizanatit, inovacionit dhe teknologjive miqësore me mjedisin. Ndër programet e tjera mund të përmendim implementimin e projekteve si “Ura Pedonale e Artit” që synon krijimin e një lagje artistike dhe tregtare pranë lumit të Lanës. Një pikë mjaft e rëndësishme është dhe ndërhyrja në industrinë e postës ushqimore për ushqimin e shpejtë (delivery). Kështu në strategjinë zhvillimore përcaktohet ngritja e një skeme për subvencionimin e paketimeve miqësore me mjedisin për të gjithë dërgesat ushqimore.

Një qëllim tjetër kryesor gjatë kësaj periudhe është shtimi me të paktën 20% i sipërfaqeve të gjelbra dhe vendosja e impianteve fotovoltaike në objekte publike për të reduktuar emetimet e karbonit. Politikat vijojnë më tej me vendosjen e impianteve fotovoltaike në 35 objekte publike si dhe vendosjen e impianteve lundruese në liqenin e Bovillës dhe Farkës. Një prioritet i Kapitullit 27 është përmirësimi i efikasitetit të burimeve dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike.

iniciativa e Bashkisë së Tiranës për mbështetje të bizneseve të gjelbra është një hap i rëndësishëm drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm dhe më të përgjegjshëm ndaj mjedisit, dhe gjithashtu një kontribut i vlefshëm për përmbushjen e objektivave të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

